



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 21.16.1-2018-08

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR MINISTRINË E PUNËVE TË
BRENDSHME
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

Prishtinë, Maj 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga *Pleurat Isufi (Udhëheqës i ekipit), Fjolla Bakalli Sadiku dhe Albana Kadriu Zogjani (Anëtare të ekipit)*, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Bujar Bajraktari*.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Qeverisja e mirë.....	24
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	28
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	33
Shtojca II: Letër konfirmimi.....	35

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 25.10.2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se vlera e pasurive kapitale, e shpalosur në në PFV ishte nënvlerësuar dhe një pjesë e shpenzimeve që i takojnë mallrave dhe shërbimeve ishin buxhetuar dhe shpenzuar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinionëve sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018

Menaxhmenti është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase.
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste substanciale si dhe aranzhimet e qeverisjes, deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund ti gjenden në Shtojcën II.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar dhe se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Ministrisë Punëve të Brendshme për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësim dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

- Ne tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se vlera e pasurive kapitale e paraqitur në PFV-të e konsoliduara të ministrisë, ishte nënvlerësuar për 592,793€. Kjo për faktin se investimi kapital që kishte të bënte me ndërtimin e Objektivit Shkollor në Akademinë Policore në Vushtrri, në vlerë 507,969€¹, si dhe pasuritë e pranuar si donacion nga Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME) në vlerë 84,824€, nuk janë përfshirë në regjistrat e pasurive.

¹ AKSP e kishte regjistruar këtë pasuri në SIMFK me datë 26.12.2018, por për shkaqe të panjohura, në raportin e pasurive në SIMFK ky regjistrim nuk figuron, dhe për këtë arsye, nuk është shpalosur as në pasqyra financiare.

- Më tej, për shkak të buxhetimit të gabuar të një numri të caktuar të projekteve kapitale² të cilat në fakt i takojnë natyrës së mallrave dhe shërbimeve, në Policinë e Kosovës (PK) kishte keqklasifikim të shpenzimeve në vlerë 171,743€. Si rrjedhojë, ishin mbivlerësuar shpenzimet kapitale dhe ishin nënvlerësuar shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve për të njëjtën shumë. Shpenzimet e keqklasifikuara përfshijnë 14 pagesa të PK me vlerë të përbashkët prej 171,743€, pajisje për shërbimin policor, pajisje të teknologjisë informative dhe mirëmbajtje të softuerit. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këto çështje.

Çështjet kyçe të auditimit

MPB, kishte shpallur në PFV detyrime kontigjente me vlerë prej 1,392,747€ që i takonin PK-së, Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK) dhe Agjencisë Kosovare të Forenzikës (AKF). Ne kemi trajtuar natyrën e lëndëve të detyrimeve të shpallura dhe mundësinë për dalje të mjeteve në të ardhmen nga një obligim i mundshëm, por për tri rastet të shpallura si detyrime kontigjente në PFV të cilat i takojnë PK-së nuk na është siguruar asnjë dëshmi që vërteton ekzistencën e një pretendimi/padie ndaj Policisë së Kosovës, për tu shpallur një detyrim i mundshëm. Një lëndë e shpallur si detyrim kontigjent ishte e mbyllur me vendim të formës së prerë nga gjykata në dobi të PK-së, në një rast tjetër PK është pala e cila ka paditur operatorin ekonomik (OE), dhe për rastin e tretë nuk kishte informata që PK është e paditur. Po ashtu, në PFV nuk figuron edhe një detyrim kontigjent i cili ishte paguar me vendim të Gjykatës në fillim të vitit 2019 për një zyrtar policor, shuma e kompenzimit për të cilin ishte 41,263€. Si rrjedhojë shpalljet e prezantuara në PFV për detyrimet kontigjente nuk mund të konsiderohen si të sakta dhe të plota.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollin e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri i Punëve të Brendshme është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të

² "Pajisje të avancuara për mbikëqyrje dhe kontroll të kufirit shtetëror" kodi i projektit 11150, "Pajisje të teknologjisë informative" kodi i projektit 30046, "Pajisje për sistemin e radiokomunikimit" kodi i projektit 12211, "Pajisjet Policore - Logjistike" kodi i projektit 30041, "Armë dhe Pajisje speciale për DNJS" kodi i projektit 30025, "Sistemi i mbikëqyrjes së kamerave", kodi i projektit 12214.

SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 për shpenzimin e parave publike dhe Rregullën Financiare nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Lidhur me dy tabelat kryesore të PFV-ve, nuk kemi asnjë çështje për të ngritur. Derisa për shpalosje janë dhënë shpjegimet më lartë tek theksimi i çështjes dhe tek çështjet kyçe të auditimit.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, me përjashtim të rasteve të cekura të theksimi i çështjes dhe çështjet kyçe të auditimit mund të konsiderohet e saktë dhe e drejtë.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e identifikuar më lartë jepet rekomandimi në vijim:

Rekomandimi C1 Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës dhe udhëheqësit e agjencive tjera në kuadër të ministrisë, duhet të rris përgjegjësinë tek stafi përgjegjës, në lidhje me dobësitë që kanë shkaktuar theksimin e çështjes. Në këtë drejtim, duhet të sigurohet se të gjitha pasuritë dhe detyrimet kontigjente janë evidentuar dhe shpalosur saktë në pasqyra financiare. Po ashtu, Ministri duhet të sigurojë që shpenzimet të planifikohen dhe të realizohen në kategorinë adekuate ekonomike me qëllim të prezantimit të drejtë të tyre në PFV.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, MPB në përgjithësi ka kontrole të mira në raport me obligimet statutorë të saj. Kontrollët mbi të hyrat në përgjithësi janë të përshtatshme dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive, por sa i përket shpenzimeve, ekzistojnë disa dobësi të përsëritura ndër vite që kërkojnë veprime korrigjuese. Këtu përfshihen dobësitë në planifikimin dhe realizimin e buxhetit në kodet e gabuara ekonomike, realizimi i ulët i investimeve kapitale, procedimi i pagesave në kundërshtim me rregullat financiare si dhe disa dobësi në menaxhimin e personelit, me theks të veçantë te mos-plotësimi i pozitive udhëheqëse me staf me kontrata të rregullta. Përkundër rekomandimeve të vazhdueshme të auditimit dhe përpjekjeve të menaxhmentit të ministrisë dhe agjencive vartëse, kjo çështje vazhdon të mbetet sfida, ngase numri i pozitive të mbajtura me UD vazhdon të jetë i madh dhe në raste të caktuara tejkalon afatet e lejuara ligjore.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ³	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Burimet e Fondeve:	123,769,325	119,589,502	113,205,329	117,486,461	104,966,519
Granti i Qeverisë -Buxheti	122,878,196	118,671,898	112,690,813	115,165,600	104,221,135
Të bartura nga viti paraprak ⁴ -	-	242	242	179,544	42,291
Të hyrat vetjake ⁵	891,129	891,129	500,000	890,887	703,093
Donacionet e jashtme	-	26,233	14,516	1,250,430	-

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 4,179,823€. Ky zvogëlim është rezultat i vendimeve të Qeverisë për "kursime" sidomos në kategorinë e investimeve kapitale.

Në vitin 2018, MPB ka shpenzuar 95% të buxhetit final ose 113,205,329€, me një përqindje më të ultë prej 3% krahasuar me vitin 2017. Edhe pse në total përqindja e realizimit është e mirë, realizimi i buxhetit në kategorinë e investimeve kapitale dhe te subvencionet dhe transferet, mbeten në nivel jo të kënaqshëm ne raport me buxhetin fillestar.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	123,769,325	119,589,502	113,205,329	117,486,461	104,966,519
Pagat dhe Mëditjet	78,810,776	79,389,764	79,388,734	76,217,698	74,860,541
Mallrat dhe Shërbimet	22,431,845	25,406,241	22,063,485	26,468,081	18,227,575
Shërbimet komunale	1,981,800	1,593,089	1,270,436	1,462,301	1,771,634
Subvencionet dhe Transferet	3,044,367	2,436,323	1,989,392	5,137,971	2,152,044
Investimet Kapitale	17,500,537	10,764,084	8,493,282	8,200,410	7,954,725

Gjatë vitit kishte shumë transfere të brendshme dhe vendime të Qeverisë të cilat kanë ndikuar që buxheti nëpër kategori ekonomike të pësojë ndryshime. Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë paraqitur më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje, në total ishte rritur për 578,988€, si rezultat i vendimit të Qeverisë për kompensimin e orëve shtesë të punës për zyrtarët policor dhe transfereve të brendshme buxhetore.

³ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

⁴ Të hyrat vetjake të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁵ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

- Rritja e buxhetit final për mallra dhe shërbime prej 2,974,396 në raport me buxhetin fillestar, është bërë pas kërkesës së MPB-së dhe agjencive të saj për transferimin e mjeteve financiare nga investimet kapitale dhe nga kategoria e shpenzimeve komunale.
- Buxheti final për shërbime komunale ishte zvogëluar për 388,711€. Realizimi te kjo kategori ishte 80% e buxhetit final ose 1,270,436€.
- Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte zvogëluar për 608,044€. Këto mjete ishin transferuar në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Realizimi i buxhetit te kjo kategori ishte 82% e buxhetit final ose 1,989,392€.
- Buxheti final për Investime Kapitale është zvogëluar për 6,736,453€. Kjo ka ndodh si pasojë e transfereve të brendshme dhe vendimeve të Qeverisë. Realizimi ishte 79% e buxhetit final apo 8,493,282€.

Rekomandimi

Çështja B1⁶ - Realizimi i buxhetit

Gjetja Sipas Ligjit të Buxhetit, ndarja e mjeteve për investime kapitale bëhet në kodet përkatëse të projekteve, ku përcaktohet edhe shuma që planifikohet të shpenzohet për secilin projekt. Kështu që shuma e ndarë me Ligj të Buxhetit duhet të shpenzohet brenda vitit fiskal ashtu siç është paraparë.

Analizat tregojnë se realizimi i buxhetit për investimet kapitale, edhe më tej mbetet sfidë me të cilën përballen MPB dhe PK. Shpenzimi vjetor në raport me buxhetin final ishte 79%, që krahasuar me vitin e kaluar është më i ultë, ndërsa po ta krahasojmë me buxhetin fillestar shpenzimi ishte vetëm 49% e buxhetit të planifikuar, dhe kjo është tregues i performancës jo të mirë në realizimin e investimeve kapitale. Me Ligjin e Buxhetit kanë qenë të planifikuara 41 projekte kapitale, ndërsa gjatë vitit 2018 shpenzime fondesh janë identifikuar vetëm në 33 projekte, çka do të thotë se 8 projekte nuk kishin filluar fare.

Shkaqet për mos-realizimin e projekteve kapitale ndërlidhen me: mungesën e kërkesave nga njësitë kërkuese, për inicimin e procedurave të prokurimit, anulimin e procedurave të prokurimit për shkak se disa projekte duhet realizuar me procedura të negociuara e jo me procedura të hapura (PK), si dhe vonesa në nënshkrimin e kontratave si pasojë e procedurave të ankesave dhe kontesteve në OSHP.

Rreziku Realizimi i dobët i buxhetit për investimet kapitale rezulton me shfrytëzim joefikas të burimeve në dispozicion, si dhe redukton efektivitetin e planeve të shpenzimeve të ministrisë. Mos-përmbushja e programit për investime kapitale rezulton me më pak projekte të realizuara si dhe mund të ndikoj në reduktim të buxhetit për vitet e ardhshme.

Rekomandimi B1 Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i PK-së duhet të ndërmarrin një vlerësim sistematik të arsyeve për mos-realizimin e projekteve kapitale, dhe për nivelin e ultë të shpenzimit të buxhetit në këtë kategori. Për tejkalimin e barrierave eventuale të identifikuar duhet të përcaktohen masa konkrete dhe praktike në mënyrë që ekzekutimi i projekteve kapitale dhe buxhetit të përmirësohet.

⁶ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
 Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
 Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga MPB dhe Agjencitë e saj për vitin 2018 ishin 55,919,738€. Të hyrat e realizuara kryesisht kanë të bëjnë me të hyrat nga taksat për regjistrimin e automjeteve, taksat rrugore, taksat për dokumente të udhëtimit, taksat për letërnjoftime, taksat për leje të vozitjes, taksat ekologjike si dhe të hyrat nga gjobat e trafikut.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Pranimet	2017 Pranimet	2016 Pranimet
Të hyrat vetjake	44,896,820	44,896,820	55,919,738	49,184,900	44,692,833
Totali	44,896,820	44,896,820	55,919,738	49,184,900	44,692,833

Siç shihet edhe nga tabela e mësipërme MPB ka inkasuar të hyra përtej parashikimit për rreth 24%. Edhe në krahasim me vitin paraprak ka një rritje për 6,734,838€ apo rreth 14%. Nga kategoritë kryesore të të hyrave, rritje më të theksuar në krahasim me vitin paraprak kishte tek të hyrat nga gjobat e trafikut, ku rritja ishte 4,917,474€, të hyrat nga taksa për dokumente të udhëtimit 2,907,951€, taksa për letërnjoftim 529,949€ etj. Derisa zvogëlim, në krahasim me vitin paraprak, kishte tek të hyrat për regjistrimin e automjeteve për 2,791,159€. Krahasuar me vitet paraprake, në përgjithësi vërehet një trend në rritje i të hyrave të arkëtuara, derisa kontrollet financiare në fushën e të hyrave janë efektive. Viteve të kaluara nuk ishte bërë planifikim për inkasimin e të hyrave, mirëpo pas rekomandimit tonë, ministria ka marrë veprimet e nevojshme për planifikimin e tyre.

Në bazë të memorandumit të mirëkuptimit me MF, të hyrat vetjake prej 819,129€ ishin lejuar të shpenzoheshin për nevojat e MPB-së, kurse pjesa tjetër e të hyrave të arkëtuara janë transferuar në Buxhetin e Kosovës (BK).

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MF. Buxheti final për paga dhe mëditje për vitin 2018 ishte 79,389,764€, ndërsa realizimi ishte 79,388,734€. Numri i planifikuar i stafit ishte 10,558, ndërsa i njëjtë ishte edhe numri aktual i të punësuarve sipas të dhënave të sistemit të pagave. Pjesa më e madhe e stafit i takon Policisë së Kosovës përkatësisht 8,754 të punësuar ndërsa pjesa tjetër i takon MPB-së dhe Agjencive tjera. Në bazë të planit të auditimit në kemi përzgjedhur 100 mostra për testim substancial dhe 11 mostra për pajtueshmëri. Testimet tona nuk kanë evidentuar ndonjë çështje që ndërlidhet me pasqyrat financiare. Çështjet e pajtueshmërisë janë paraqitur në nënkapitullin e mëposhtëm.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.3 Menaxhimi i personelit

Në këtë pjesë janë paraqitur çështjet e identifikuara që kanë të bëjnë me dobësitë në menaxhimin dhe organizimin e personelit. Nga testimet tona identifikuam çështjet në vijim:

Çështja B2 - Ushtrimi i pozitave të punës në mospërputhje me gradat e fituara

Gjetja UA Nr. 04/2017 për rregullimin e marrëdhënies së punës në PK (i cili ka qenë në fuqi për vitin 2018), parasheh që me rastin e sistemimit të punonjësve apo caktimit në pozita të lira të punës, duhet të përfillen kushtet dhe kriteret që parashihen për ato pozita, përfshirë kualifikimin, gradën, përvojën etj. Derisa sipas sistemit të pagave të PK-së, koeficienti i pagës bazë për stafin policor përcaktohet në varësi të gradës dhe jo në bazë të pozitës së punës.

Ne kemi vërejtur se në PK vazhdojnë të ushtrohen pozita të punës nga zyrtarë policor që nuk posedojnë gradën adekuate të cilën e kërkon pozita e ushtruar, dhe vazhdojnë të kompensohen në bazë të pozitës. Kjo është në mospërputhje me sistemin e pagave të PK-së. Sipas të dhënave të raportuara nga njësia e personelit të PK-së për vitin 2018, numri i zyrtarëve policor që ushtrojnë pozita në mospërputhje me gradën e arritur ishte 343. Prej tyre, 191 zyrtarë ushtronin nga një gradë më të lartë, 16 të tjerë nga dy deri në tri grada më të larta, dhe pjesa tjetër ushtronin pozita që kërkojnë grada më të ulëta. Lidhur me këtë çështje ne kemi rekomanduar edhe në vitet paraprake. Përkundër kësaj, gjatë vitit 2018 ka vazhduar praktika e njëjtë.

Nuk kemi marrë ndonjë sqarim të vlefshëm në lidhje me arsyet/shkaqet për mos zbatimin e rekomandimit tonë në lidhje me këtë çështje.

Rreziku Ushtrimi i gradave jo në pajtim me UA dhe kompensimi sipas pozitave, është në mospërputhje me sistemin e pagave, dhe rrit rrezikun që pozitat të menaxhohen nga persona që nuk i plotësojnë kriteret e nevojshme. Kjo ndikon në rritje të shpenzimeve dhe dëmtim të buxhetit.

Rekomandimi B2 Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i PK-së duhet të sigurojnë që sistemimi i stafit policorë në pozita të lira bëhet pas plotësimit të kriterëve apo rekrutimit të rregullt brenda PK dhe kompensimi i të punësuarve të bëhet në përputhje me gradat dhe sistemin aktual të aprovuar të pagave.

Çështja B3 Marrëveshje për shërbime të veçanta në pozitat e rregullta dhe afat më të gjatë se sa lejohet me ligj

Gjetja Sipas nenit 12.4 të Ligjit për Shërbimin Civil, emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta” të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

Në AME numri i të punësuarve me marrëveshje për shërbime të veçanta ishte 11 (7 prej tyre në pozita të rregullta si zyrtar të financave, personelit, për marrëdhënie me publikun, logjistikë etj). Në katër raste, kohëzgjatja e marrëveshjeve ishte nga data 01.01.2018–31.12.2018 duke e tejkaluar afatin ligjor të paraparë për zbatim të këtyre marrëveshjeve.

Rreziku Angazhimi i punonjësve me kontrata mbi shërbimet e veçanta në pozitat e rregullta të punës, dëmton konkurrencën dhe rritë rrezikun e angazhimit të stafit jo kompetent që mund të afektoj edhe arritjen e objektivave të organizatës. Ndërsa, angazhimi i tyre më gjatë se gjashtë muaj brenda një viti, është në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Rekomandimi B3 Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e përgjithshëm të AME-së duhet t’i shqyrtojnë arsyet pse rastet e tilla kanë ndodhur, dhe të ndërpresin praktikën e angazhimit të përkohshëm të stafit për pozitat e rregullta. Në rast të nevojave për shërbime të veçanta, ato duhet të sigurohen duke ju nënshtruar kërkesave dhe procedurave ligjore.

Çështja A1 – Mangësi në procedurën e angazhimit me marrëveshje për shërbime të veçanta

Gjetja Sipas konkursit të shpallur nga AME për angazhim me marrëveshje për shërbime të veçanta në pozitën e zyrtarit të financave, ishin përcaktua kriteret specifike të cilat kandidatët do duhej t'i plotësonin. Tek kualifikimi profesional ishte kërkuar diplomë universitare në drejtimin ekonomik, financa, biznes apo të ngjashme.

Ne kemi gjetur se asnjë nga tre aplikantët nuk e plotësonte kriterin e arsimimit dhe kualifikimit profesional dhe të gjithë ishin vlerësuar me pikë (nga 10-20) nga komisioni vlerësues. Përveç kësaj, kishte dobësi edhe në vlerësimin e testit me shkrim të kandidatëve, ku në disa raste për përgjigjen e njëjtë, dy kandidatë ishin poentuar ndryshe, si dhe në raste tjera për përgjigje të ndryshme në të njëjtën pyetje, kandidatët kishin marrë vlerësim të njëjtë.

Zyrtarët e AME nuk kanë qenë në gjendje për të na dhënë ndonjë shpjegim të arsyeshëm në lidhje me shkaqet pse kanë ndodhur këto gabime/mangësi.

Rreziku Dështimi në zbatimin e kriterëve dhe procedurave të parapara ligjore në procesin e angazhimit të stafit, minimizojnë konkurrencën dhe rrisin rrezikun e angazhimit të personave jo adekuat për pozitat e caktuara.

Rekomandimi A1 Drejtori i Përgjithshëm i AME-së duhet të sigurojë që në rast të nevojës për të angazhuar staf për kohë të shkurtër, do të respektohen të gjitha procedurat ligjore, duke përfshirë edhe vlerësimin korrekt dhe të bazuar të kandidatëve nga komisioni rekrutues.

3.1.4 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë shërbimet komunale) për vitin 2018 ishte 26,999,330€. Prej tyre ishin shpenzuar 23,333,921€ apo 86% e buxhetit final. Këto shpenzime kanë të bëjnë me furnizim me material zyrtar, furnizim me derivate, furnizim me veshëmbathje, mirëmbajtja e sistemit të letërnjoftimeve, pasaportave dhe patentë shoferëve, furnizim me ushqim dhe pije, sigurimin e ndërtesave etj. Nga testimet tona identifikuam çështjet si në vijim:

Rekomandimet

Çështja A2 – Mungesë e deklaratës me shkrim për tenderin me çmime jo-normalisht të ulët

Gjetja Sipas Ligjit dhe rregullave të zbatueshme të Prokurimit Publik, në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit) duket të jetë jo normalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues (AK) duhet të kërkoj me shkrim nga OE i cili ka dorëzuar tenderin që duket të jetë jo-normalisht i ultë, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevante të tenderit dhe e cila përfshinë një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jo-normalisht të ulët"⁷.

Në kontratën e nënshkruar "Mirëmbajta dhe servisimi i automjeteve të IPK-së" në vlerën prej 59,835€, OE fitues kishte ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta për disa artikuj⁸. AK nuk kishte kërkuar deklaratë me shkrim nga OE, në lidhje me çmimet e ofruara.

Sipas deklarimeve të zyrtarëve, nuk është parë e nevojshme dërgim i shkresës standarde për tenderët jo-normalisht të ulët nga ana e AK tek OE.

Rreziku Ofertimet e artikujve me çmime jo normalisht të ulëta, mund të kenë qenë përcaktuese në dhënien e kontratës, duke rrezikuar eliminimin nga konkurrenca të operatorëve tjerë që kanë ofertuar me çmime normale të tregut. Mos ndjekja e procedurave të duhura të prokurimit dhe udhëzuesve përkatës, mund të rezultoj në mos-gatishmërinë e OE për të furnizuar entitetin me artikujt e kontraktuar.

Rekomandimi A2 Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së të sigurohet që çdo kontratë të nënshkruhet pasi të jenë zbatuar të gjitha procedurat e kërkuara me LPP dhe rregulloret plotësuese. Në rastin e ofertave me çmime jo-normalisht të ulëta, të shqyrtohet besueshmëria e tenderëve dhe të kërkojnë sqarimet e nevojshme nga komisioni vlerësues i ofertave para se të procedohet me hapat e mëtejshëm.

⁷ B 57 Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët

⁸ Psh: çmimi i ofertës fituese për "Alternator" për veturën Hyundai accent është 1,25€, derisa oferta e ofertës së dytë për këtë artikull ishte 70€, për artikullin amortizer i pasëm (për veturat Hyundai Accent, Nisan Patrol dhe Golf IV) ishin 1,25€, derisa çmimi i ofertës së dytë ishte 20€. Po ashtu kishte edhe shumë artikuj tjerë me çmime jo normalisht të ulëta si: Sistemi i frenimit ABS për veturën Hyundai Accent 1,25€, për BMW 1,3€, për golf V 0,50€, brava e derës 0,25€, 0,14€ etj, artikulli - boshpumpa për Hyundai Accent 1,19€ etj.

3.1.5 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere për vitin 2018 ishte 2,436,323€. Shpenzimet për vitin 2018 ishin 1,989,392€, apo 82% e buxhetit final. Këto pagesa kryesisht kanë të bëjnë me përkrahje financiare me qëllim të ri-integritit të personave të riatdhesuar si dhe përkrahje për punonjësit e Policisë së Kosovës. Ne kemi përzgjedhur dhjetë (10) mostra me vlerë 517,631€ për teste substanciale, dhe pesë (5) mostra me vlerë 397,310€ për pajtueshmëri. Testimi i këtyre mostrave nuk ka rezultuar me ndonjë parregullësi.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.6 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 10,764,048€. Nga ky buxhet janë shpenzuar gjithsej 8,493,282€, apo shprehur në përqindje 79% e buxhetit final. Krahasuar me vitin paraprak përqindja e realizimit është për 19% më e ulët. Buxheti për investime kapitale kryesisht përdoret për: ndërtimin dhe riparimin e objekteve, blerjen e automjeteve, blerjen e pajisjeve të ndryshme për policinë, etj. Ne kemi përzgjedhur 62 pagesa me vlerë të përbashkët 3,536,826€ për testim substancial, dhe pesë (5) kontrata me vlerë të përbashkët 1,022,520€, për testim të pajtueshmërisë. Testimet tona nuk kanë vënë në pah ndonjë çështje për tu raportuar. Çështja e mos realizimit të disa projekteve është shpalosur më lartë në këtë raport, tek kapitullit Realizimi i Buxhetit.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.7 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale

Në vijim janë paraqitur çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

Çështja B4 - Mangësi në procesimin e pagesave

- Gjetja** Rregulla financiare Nr.01/2013 përcakton që fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, zotimi i mjeteve, procedohet urdhër-bleerja, pastaj të pranohet malli apo shërbimi, dhe pas pranimit të faturës të ekzekutohet pagesa.
- Nga mostrat e testuara në kategorinë e investimeve kapitale si dhe mallrave dhe shërbimeve, në 20 raste kemi vërejtur se zotimi dhe urdhërbleerja janë lëshuar pas pranimit të mallit/shërbimit dhe pas pranimit të faturës. Kjo është në kundërshtim me procedurat e përgjithshme për procedimin e pagesave që përcaktohen me rregulloren në fuqi
- Sipas zyrtarëve kompetent procedimi i urdhërbleerjes pas pranimit të faturës, në raste të caktuara është bërë me qëllim që mjetet të mos bllokohen në rast se nuk arrijnë të realizohen ato furnizime, derisa, ka pasur mungesë të mjeteve në kohën e duhur për disa pagesa tjera, e që si pasojë janë vonuar në nxjerrjen e zotimeve dhe shlyerjen e obligimeve.
- Rreziku** Mos ndjekja e procedurave të duhura të kontrollit gjatë kryerjes së pagesave, është shmangie nga kërkesat ligjore dhe mund të rezultojë me pagesa potencialisht të parregullta.
- Rekomandimi B4** Ministri duhet të siguroj se zyrtarët financiar zbatojnë me konsistencë procedurat e shpenzimeve sipas hapave të përcaktuar me rregulloren e shpenzimeve për paratë publike, dhe rastet e tilla të mos përsëriten.

3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Në PFV-të e MPB-së, të vitit 2018, ishin shpalosur 46,381,987€ pasuri kapitale (me vlerë mbi 1,000€) dhe 3,909,391€ pasuri jo kapitale (me vlerë nën 1,000€). Ne kemi testuar blerjet e vitit, përfshirë investimet kapitale dhe blerjet e pajisjeve dhe mobiljeve nën 1,000€, si dhe rregullsinë në menaxhimin e regjistrave dhe inventarizimin e pasurisë. Testimet tona kanë vënë në pah çështjet në vijim:

Rekomandimet

Çështja B5 - Menaxhimi i flotës së automjeteve

Gjetja Servisimi dhe riparimi i automjeteve varësisht nga prishjet për të cilat janë dërguar në Flotën e Policisë, sipas rregullave të tyre duhet të kryhet brenda një periudhë optimale (1-3 muaj).

Ne kemi vërejtur se menaxhimi me flotën e automjeteve e PK-së ku bëhet servisimi dhe riparimi i automjeteve vazhdon të jetë ende i dobët. Vazhdon të ketë vonesa të stërzgjatura në riparimin e automjeteve, ku një numër i tyre ishin në pritje për riparim që nga viti 2016. Numri i automjeteve që presin për riparim janë: 16 automjete nga viti 2016, 35 automjete nga viti 2017 dhe 45 të vitit 2018.

Arsyet e pritjes kaq të gjatë për riparim të automjeteve sipas zyrtarëve të flotës janë: mungesa për një kohë të gjatë e kontratave për furnizim. Shumica e automjeteve në pritje janë të prodhuesit Volkswagen ku PK nuk ka pasur kontratë për furnizim që nga 19.09.2015, pavarësisht se një kontratë ishte lidhur me 15.03.2017 dhe pas kërkesave nga personeli i flotës për furnizim me pjesë, ata nuk kishin marrë furnizimet të cilat do t'i bënin funksionale këto automjete, vjetërsia e automjeteve, numri i vogël i stafit etj.

Rreziku Dobësitë në menaxhimin e flotës së automjeteve, reduktojnë kapacitetin operativ të PK-së për të ushtruar pa pengesë aktivitetet e përditshme.

Rekomandimi B5 Ministri në bashkëpunim më Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së duhet të bëjnë një vlerësim të gjendjes aktuale në flotën e automjeteve për të përcaktuar veprimet e nevojshme për përmirësimin e procesit të servisimit të automjeteve.

Çështja B6 – Mangësi në menaxhimin e regjistrave të pasurisë dhe procesin e inventarizimit

Gjetja Sipas rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, të gjitha pasuritë jo financiare pas pranimit në pronësi të organizatës buxhetore, duhet të regjistrohen në regjistrat kontabël, ndërsa inventarizimi i pasurisë duhet të kryhet para përfundimit të PFV.

AME nuk i ka regjistruar pasuritë me vlera nën 1,000€, në sistemin e-pasuria (me përjashtim të pesë artikujve). Përveç kësaj, AME nuk kishte bërë inventarizimin e pasurisë për vitin 2018. Sa i përket MPB dhe departamenteve në kuadër të saj, raportin për inventarizimin e pasurisë e kanë përfunduar me datë 28.02.2019, pra pasi që kanë korrigjuar PFV-të. Kjo do të thotë që raporti i inventarizimit nuk është harmonizuar me regjistrat e pasurisë.

Mosregjistrimi i pasurive nga AME ka ndodhur për shkak të paqartësisë në mes të Ministrisë dhe AME-së në lidhje me qasjen e zyrtarëve në sistemin e-pasuria. Ministria nuk i ka evidentuar këto pasuri në regjistrer derisa zyrtarit të pasurisë në AME ju ka krijuar qasja në e-pasuri vetëm në vitin 2019. Në lidhje me çështjen e inventarizimit të pasurive, ne nuk kemi marrë ndonjë shpjegim të arsyeshëm.

Rreziku Mungesa e regjistrimit të pasurisë nën 1,000€ si dhe mungesa e inventarizimit të pasurisë, paraqet rrezik që pasuria e deklaruar në PFV të mos jetë e saktë pasi që nuk është bërë regjistrimi i plotë, si dhe nuk është bërë numërimi fizik i saj.

Rekomandimi B6 Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i AME-së duhet të sigurojnë që e gjithë pasuria me vlerë nën 1,000€, të regjistrohet në e-pasuria, si dhe të bëhet inventarizimi i pasurisë dhe të harmonizohen raportet e inventarizimit me regjistrat e pasurive para së të përgatiten PFV e vitit 2019.

3.3 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj

Pasqyra e avanceve të hapura të prezantuara në PFV në fund të vitit 2018 ishte 68,929.61€. Prej tyre avance në vlerë 34,981€ i takonin vitit aktual dhe kanë të bëjnë me dy avance të zyrtarëve policor që kanë shkuar për trajnime jasht vendit (trajnime që zgjasin më shumë) dhe pritjet të mbylljen pasi ata të kthehen nga trajnimi, ndërsa vlera prej 33,949€ janë avance të bartura nga vitet paraprake. Në krahasim me vitin paraprak shuma e avanceve të pambyllura të bartura, është zvogëluar për 16,674€.

Çështja B7 - Avancet e hapura

- Gjetja** Avancet e hapura nga vitet e kaluara duhet të mbyllën me se largu deri në fund të periudhës së parë të vitit pasues.
- MPB kishte paraqitur në PFV avance të hapura në vlerë prej 68,929.61€, prej të cilave 33,948.61€ kishin të bënin me avance të bartura që nga vitit 2010. Sipas zyrtarëve të MPB-së dhe PK-së, këto avance figurojnë si të hapura në MF por entiteti akoma nuk ka arritur t'i identifikoj se për cilat avance bëhet fjalë, dhe sipas të dhënave të MPB, të gjitha avancet figurojnë të mbyllura.
- Nga dëshmitë e siguruarra PK dhe MPB kanë kërkuar disa herë nga Ministria e Financave informata për vlerën prej 33,949€ e cila sipas zyrtarëve të MPB ato do duhej të figuronin si të mbyllura, por ende nuk kanë arritur që me MF ta zgjidhin këtë problem.
- Rreziku** Mos-mbyllja e avanceve të hapura rrit rrezikun që mjetet e shpenzuara të mos jenë përdorur për qëllimin e paraparë.
- Rekomandimi B7** Drejtori i Përgjithshëm i PK-së duhet të merr të gjitha masat që në bashkëpunim me Ministrinë e Financave ta sqaroj çështjen e avanceve të hapura, të trashëguara nga vitet e mëparshme dhe të siguroj se problemi i tillë nuk do të shfaqet në të ardhmen.

3.4 Të arkëtueshmet

Të hyrat e pambledhura nga MPB (PK) të prezentuara në PFV ishin në vlerë prej 7,720,214€. Krahasuar me vitin paraprak vlera e llogarive të arkëtueshme është më e lartë për 1,063,569€. Shumica dërmuese e llogarive të arkëtueshme ishin nga gjobat e Policisë apo 6,808,914€. Nga lista e këtyre llogarive, ne kemi përzgjedhur 29 mostra dhe testimi ka rezultuar me çështjen e paraqitur në vijim:

Rekomandimet

Çështja A3 - Regjistrimi jo i saktë i shumës së gjobave

- Gjetja** Llogaritë e arkëtueshme duhet të paraqiten në regjistrat e Policisë së Kosovës me shumën më të cilën është gjobitur pala e jo sipas limitit më të lartë të cilin e lejon neni i ligjit përkatës.
- Ne kemi vërejtur se në pesë raste, vlera e gjobave mandatore të paraqitura në regjistrat nuk është e njëjtë me gjobën që ju ka shqiptuar shkelësve të ligjit, por është paraqitur vlera më e lartë bazuar në nenit përkatës të ligjit. Vlera e këtij gabimi ishte 11,290€.

Kjo ka ardhur si pasojë e futjes së gabueshme të informatave në sistemin elektronik, pasi që ndërlihdja elektronike e dënimeve me regjistrin është bërë bazuar në nenet e ligjeve të cilat parashohin maksimumin e gjobave, e jo në bazë të shumës së gjobave që janë shqiptuar.

Rreziku

Regjistrimi i shumës së dënimit mandator sipas kufirit më të lartë të dënimit që parasheh ligji, dhe jo sipas shumave në bazë të të cilave janë shqiptuar dënimet, paraqet rrezik që PK të paraqes shuma të cilat nuk janë të sakta dhe të njëjtat të japin informata çorientuese në PFV.

Rekomandimi A3 Drejtori i përgjithshëm i PK-së duhet të siguroj që regjistrimi i dënimeve mandatore në sistemin elektronik të bëhet në bazë të shumave që janë shqiptuar në dënime, në mënyrë që informatat lidhur me këto llogari të jenë të sakta dhe si të tilla, të raportohen në PFV.

3.5 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte 1,704,889. Prej tyre për mallra dhe shërbime 1,452,277€, për shërbime komunale 17,345€ dhe për investime kapitale 235,267€. Pjesa më e madhe e obligimeve tek mallrat dhe shërbimet ka të bëjë me dy fatura për furnizim me uniforma për zyrtarët policor, me vlerë të përbashkët prej 1,122,362€. Këto fatura kanë ardhur në fund të dhjetorit dhe nuk ka pasur mundësi që të paguhen. Njëkohësisht, kjo ka ndikuar që të ketë rritje të obligimeve në krahasim me vitin paraprak. Për një pjesë të obligimeve, sidomos te Investimet Kapitale, Ministria e Financave pa paralajmërim i ka stopuar pagesat duke i prishur edhe zotimet, derisa një pjesë e obligimeve për furnizime/shërbime si dhe shërbime komunale faturat kanë ardhur në fund të dhjetorit 2018 dhe në janar 2019. Këto obligime janë bartur për pagesë në vitin 2019.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollat. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

MPB në përgjithësi ka kontrollë të mira në raport me obligimet ligjore të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli ka dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit. Kërkesa për plotësimin e pyetësorit të vetëvlerësimit ishte përmbushur brenda afatit ligjor nga MPB dhe Agjencitë e saj.

Megjithatë mbesin një numër fushash ku nevojiten zhvillime të mëtejshme. Këtu përfshihet përgjigja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit dhe adresimi i tyre në shkallë më të lartë. Zbatimi i kërkesave për vlerësim dhe menaxhim të rrezikut ende nuk mund të konsiderohen si plotësisht i vendosur dhe efektiv. Përkundër zhvillimeve në identifikimin dhe përcaktimin e rreziqeve potenciale nga agjencitë e MPB-së (IPK dhe AKSP), ky proces ende nuk ka arritur të jetë gjithëpërfshirës në nivel institucional, dhe mungojnë mekanizmat e monitorimit dhe rishikimit të vazhdueshëm të planit për menaxhimin e rrezikut.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

MPB dhe tri agjencitë në kuadër të saj (PK, IPK dhe AKSP), kanë të themeluar Njësitë e Auditimit të Brendshëm (NjAB) të cilat operojnë me: katër auditorë në MPB, pesë auditorë në PK, dhe një auditor në IPK. Secila njësi kishte hartuar planin strategjik dhe planin vjetor të auditimit të bazuar në vlerësim të rrezikut, ndërsa fushëveprimi i auditimeve të kryera përfshinte auditime të llojit të pajtueshmërisë, performancës, sistemit dhe të transaksioneve.

Në planet vjetore të NjAB-ve për vitin 2018 ishin planifikuar gjithsej 33 auditime të rregullta, duke mos përfshirë auditimet me kërkesë. Gjatë vitit 2018 ishin finalizuar gjithsej 30 raporte duke e përmbushur pothuajse në tërësi planifikimin, me përjashtim të AKSP e cila nuk kishte arritur të përfundoj të gjitha auditimet sipas planit. Përveç auditimeve të rregullta, ishin kryer edhe tri auditime me kërkesë, prej të cilave një nga NjAB e PK-së, dhe dy nga NjAB e MPB-së.

Komiteti i auditimit (KA), kishte mbajtur pesë takime të rregullta ku janë shqyrtuar gjetjet dhe rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm si dhe veprimet e ndërmarra për adresim të rekomandimeve.

Çështja A4 - Mos përmbushja e planit vjetor të auditimit në AKSP

Gjetja Sipas planit vjetor të NjAB në AKSP ishte planifikuar që për vitin 2018 të kryheshin pesë auditime, por kjo njësi gjatë vitit 2018 kishte kryer vetëm dy auditime. Kjo gjendje kishte ardhur si pasojë e transferimit të auditorit të AKSP-së në MF. Kjo njësi kishte vetëm një auditor dhe transferimi i tij në MF kishte ndodhur në muajin korrik.

Rreziku Mos përmbushja e planit të NjAB, mund të ndikoj në mos identifikimin dhe mos adresimin e dobësive të mundshme në kontrole si dhe të humbet mundësia për përmirësime.

Rekomandimi A4 Drejtori i AKSP-së duhet të sigurojë që pozita e mbetur e lirë të plotësohet brenda një afati të arsyeshëm kohor.

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

MPB në përgjithësi kishte dizajnuar një mjedis të mirë të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe raportimit brenda saj dhe në raport me agjencitë ekzekutive. Procesi i raportimit të brendshëm funksionon sipas zinxhirit llogaridhënës dhe strukturës organizative. Ekzistojnë raportime të rregullta nga agjencitë në konsolidimin e të dhënave rreth gjendjes financiare në nivel institucional. Mbetet t'i kushtohet më shumë rëndësi zbatimit të kërkesave për vlerësim të rrezikut për të mbështetur menaxhimin efektiv operacional dhe strategjik.

Rekomandimi

Çështja B8 - Dobësi në menaxhimin e rrezikut

Gjetja Sipas procedurës së MFK nr.4, e cila flet për menaxhimin e rrezikut, regjistri i rrezikut duhet të ketë datë dhe të rishikohet rregullisht (rekomandohen rishikime tremujore) për të përcaktuar nëse janë marrë veprimet ashtu siç është planifikuar dhe nëse është bërë ndonjë ndryshim në vlerësimet e rrezikut. Regjistri i rishikuar i rrezikut, duhet të nxirret pas secilit rishikim dhe të azhurnohet sipas nevojës.

MPB dhe agjencitë në kuadër të saj kanë bërë disa zhvillime në identifikimin dhe përcaktimin e rreziqeve potenciale përmes hartimit të regjistrit të rreziqeve. Me përjashtim të IPK-së, nga MPB dh AKSP nuk dihet data e përpilimit të regjistrit të rrezikut. Po ashtu, nuk është bërë monitorimi dhe rishikimi i regjistrave të rrezikut në baza të rregullta kohore, ashtu siç rekomandohet nga procedurat e MFK-së.

Bazuar në deklaratat e zyrtarëve rreziqet zakonisht janë të njëjta përgjatë tërë vitit, prandaj nuk është parë e arsyeshme që regjistrat të azhurnohen.

Rreziku Mungesa e monitorimit të rrezikut mund të dobësoj cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve nëse rreziqet që ndikojnë në arritjen e objektivave, nuk adresohen në kohën e duhur. Kjo, për shkak se veprimet pro aktive të nevojshme për të parandaluar ose evituar ndikimin e çështjeve të tilla nuk do të ndërmerren në mënyrë të planifikuar dhe sistematike.

Rekomandimi B8 Ministri duhet të siguroj që personat përgjegjës janë duke i përmbushur të gjitha obligimet në lidhje me menaxhimin e rrezikut, përfshirë këtu edhe vendosjen e mekanizmave adekuat të rishikimit dhe raportimit për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2017 të MPB-së ka rezultuar në 20 rekomandime kryesore. MPB kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit për vitin 2018, tetë (8) rekomandime janë zbatuar; tetë (8) ishin në proces dhe katër (4) nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Tabelën 4.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i PK-së duhet të sigurojnë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksimin e Çështjes. Në këtë aspekt, llogaritë e arkëtueshme duhet të identifikohen saktë dhe të shpalosen në PFV;	Llogaritë e arkëtueshme ishin shpalosur në PFV. Menaxhmenti kishte bërë përpjekje që procesin e buxhetimit dhe shpenzimeve të mallrave dhe shërbimeve të mos bëhen nga kategoria e Investimeve Kapitale, por edhe për këtë periudhë gjendja është pothuaj e njëjtë.	Rekomandimet pjesërisht të zbatuara
2		Gjithashtu, Ministri duhet të sigurojë që shpenzimet të planifikohen dhe të shpenzohen në kategorinë adekuate ekonomike me qëllim të prezantimit të drejtë të tyre në PFV. Procesi i hartimit të PFV të vitit 2018 duhet të përfshijë edhe rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe fushat ku janë identifikuar gabime. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.		
3	Procesi i buxhetit	Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i PK-së duhet të ndërmarrin një vlerësim sistematik të arsyeve për mos-realizimin e projekteve kapitale, dhe për nivelin e ulët të shpenzimit të buxhetit në këtë kategori. Për tejkalimin e barrierave eventuale të identifikuar duhet të përcaktohen masa konkrete dhe praktike në mënyrë që ekzekutimi i projekteve kapitale dhe buxhetit të përmirësohet.	Gjendja vazhdon të jetë e njëjtë.	Rekomandim i pa zbatuar
4	Të hyrat	Ministri duhet të sigurojë që të bëhet parashikimi/planifikimi i përafërt i të hyrave në mënyrë që të mundësohet matja e performancës së Institucionit.	Është bërë një planifikim fillestar i të hyrave që pritet	Rekomandim i zbatuar

			të arkëtohen nga MPB	
5	Menagjim i i Personelit	Ministri, Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtorët e Agjencioneve duhet të sigurojnë që brenda një periudhe kohore të arsyeshme të inicohen procedurat për rekrutimin e stafit të rregullt për të gjitha pozitat të cilat mbahen nga ushtruesit e detyrës.	Gjendja e njëjtë.	Rekoman dim pjesërisht i zbatuar
6		Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i PK duhet të sigurojnë që sistemimi i stafit policorë në pozita të lira të bëhet pas plotësimit të kriterëve apo rekrutimit të rregullt brenda PK dhe kompensimi i të punësuarve të bëhet në përputhje me gradat dhe sistemin aktual të aprovuar të pagave.		Rekoman dim i pa zbatuar
7		Ministri duhet të iniciojë një rishikim gjithëpërfshirës për të përcaktuar saktë nevojat për staf, me qëllim që të gjitha pozitat e nevojshme të plotësohen me staf të rregullt. Në rast se shfaqet nevoja për të angazhuar staf për kohë të shkurtër, atëherë duhet të zhvillohen procedurat e kërkuara sipas dispozitave ligjore.	Në AME janë angazhuar zyrtar me MSHV në pozitat të rregullta të punës. Gjatë procedurave kishte mangësi.	Rekoman dim i pa zbatuar
8	Mallra dhe shërbime	Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i PK-së duhet të sigurojnë që pagesat të kryhen në pajtim të plotë me afatet e përcaktuara në LMFPD dhe Rregullat e Thesarit.	Gjendja e njëjtë.	Rekoman dim pjesërisht i zbatuar
9	Subvencione dhe transfere	Ministri duhet të kërkojë nga personat përgjegjës forcimin e mekanizmave për menaxhim dhe monitorim të subvencioneve, në mënyrë që të merret siguri e arsyeshme që paratë e dhëna si subvencion shfrytëzohen drejtë dhe në pajtim me qëllimin e synuar.	Në këtë vit këto lloj subvencionesh kishin kaluar në kompetencë të MPMS.	Rekoman dim i Zbatuar
10	Investime Kapitale	Ministri dhe Drejtori i Policisë së Kosovës duhet të sigurojnë që procedurat e vlerësimit të ofertave të përfundohen brenda afateve të parapara kohore të përcaktuara me legjislacionin dhe udhëzimet në fuqi.	Vlerësimi i tenderëve ishte bërë brenda afateve të parapara kohore.	Rekoman dimi i zbatuar.
11	Investime Kapitale	Ministri duhet të sigurojë që me rastin e inicimit të procedurave për projekte të reja ndërtimore, ti kushtohet më shumë vëmendje specifikimit të kërkesave edhe planifikimi i objekteve të bëhet duke pasur parasysh të gjitha elementet që e përbëjnë objektin si tërësi funksionale. Kjo do të ndihmonte, që të mos ketë vonesa në	Projekti ishte përfunduar pas këtyre afateve dhe ishte bërë pranimi teknik.	Rekoman dimi i zbatuar.

		implementimin e projekteve si dhe të mos shfaqet nevoja për mjete financiare shtesë.		
12	Çështje të përbashkëta mallra dhe shërbime dhe investime kapitale	Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i AKSP duhet të shtojnë kontrollet tek procesi i prokurimit dhe të sigurojnë që të gjitha procedurat dhe afatet ligjore të respektohen me përpikëri.	Nuk kemi hasur këtë vit në kesi lloj gjetjesh.	Rekoman dimi i zbatuar.
13	Çështje të përbashkëta mallra dhe shërbime dhe investime kapitale	Ministri dhe Drejtori i PK-së duhet të sigurohen që procedimi i pagesave të bëhet në përputhje me kërkesat dhe procedurat e përcaktuara ligjore. Duhet të ndërmerren masa parandaluese për të siguruar furnizimin me kohë me artikujt e kontraktuara dhe për çdo vonesë të aplikohen ndalesat e parapara me kontrata.	Kryesisht vazhdon gjendja e njëjtë.	Rekoman dim pjesërisht i zbatuar
14	Pasuritë	Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i PK-së duhet të sigurojnë që të gjitha pasuritë e blera të regjistrohen me rastin e pranimit dhe të klasifikohen në kategoritë adekuate, konform rregullave të përcaktuara. Poashtu duhet të sigurohet që pasuria e blerë si projekt kapital të regjistrohet sipas vlerës së saj të plotë.	Janë marrë disa veprime dhe ishin regjistruar pasuritë në PK, ndërsa në MPB gjendja është pothuajse e njëjtë.	Rekoman dim pjesërisht i zbatuar
15	Pasuritë	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së duhet të bëjnë një vlerësim të gjendjes aktuale në flotën e automjeteve për të gjetur shkaqet e vonesave dhe për të përcaktuar veprimet e nevojshme për përmirësimin e procesit të servisimit të automjeteve.	Gjendja e njëjtë.	Rekoman dim i pa zbatuar
16	Pasuritë	Ministri, Drejtori i Përgjithshëm i PK-së dhe Drejtori i IPK-së, duhet të iniciojnë një rishikim të arsyeve pse kanë ndodhur vonesat e inventarizimit të pasurive, dhe të mbajnë përgjegjës personat që kanë marrë pjesë në këtë proces. Në kontekst të sigurimit të informatave të sakta për PFV-të duhet të sigurohet që inventarizimi i pasurisë për vitin 2018 të përfundohet para dorëzimit të PFV-ve në MF.	Janë marrë disa veprime konkrete. PK dhe IPK e kanë kryer me kohë inventarizimin, MPB me vonesë, ndërsa AME nuk kishte bërë fare inventarizim.	Rekoman dim pjesërisht i zbatuar
17	Trajtimi i parasë së gatshme dhe	Ministri duhet të sigurojë që zyrtarët përgjegjës të verifikojnë faktet në mënyrë që të gjinden shkaqet dhe të eliminohen dilemat nëse këto	Pavarsisht përpjekjeve të PK dhe MPB,	Rekoman dim i pa zbatuar

	ekuivalentëv e të saj	janë avance të arsyetuara apo jo. Rrjedhimisht duhet shtuar kujdesi në procesin e menaxhimit të parave të gatshme në mënyrë që gabimet e tilla të mos përsëriten në te ardhmen.	gjendja ishte pothuajse e njëjtë edhe në vitin 2018.	
18	Obligimet e papaguara	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e PK-së duhet të sigurojnë kontrolle shtesë në raportimin e obligimeve, ashtu që vlerat e sakta të raportohen për periudha kohore, gjendja e obligimeve të përcillet për çdo muaj dhe pagesat të bëhen me kohë.	Nga testet e bëra rezulton se të gjitha obligimet ishin paraqitur në PFV.	Rekomandim i zbatuar.
19	Progresi në zbatimin e rekomandimeve	Ministri në bashkëpunim me Drejtorët e agjencive duhet të zbatojnë një proces efektiv monitorues të planit për zbatimin e rekomandimeve. Në bazë të rezultateve nga ky monitorim duhet të vlerësohet nëse ky plan është i zbatueshëm, të identifikohen sfidat eventuale që ndikojnë në mos-zbatimin e rekomandimeve dhe të propozohen dhe ndërmerren masa alternative në rast nevojë.	Një pjesë e mirë e rekomandimeve janë zbatuar dhe disa të tjera ishin në proces të zbatimit.	Rekomandim i mbyllur-pjesërisht i zbatuar.
20	Raportimi menaxherial	Ministri në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm dhe Drejtorët e Agjencive duhet të sigurojnë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut si dhe duhet të vendosin mekanizma të rishikimit dhe raportimit për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.	Janë marrë disa veprime, mirëpo lista e rreziqeve ende duhet përpunuar.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar.
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
1	PFV	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës dhe udhëheqësit e agjencive tjera në kuadër të ministrisë, duhet të rris përgjegjësinë tek stafi përgjegjës, në lidhje me dobësitë që kanë shkaktuar theksimin e çështjes. Në këtë drejtim, duhet të sigurohet se të gjitha pasuritë dhe detyrimet kontingjente janë evidentuar dhe shpalosur saktë në pasqyra financiare. Po ashtu, Ministri duhet të sigurojë që shpenzimet të planifikohen dhe të realizohen në kategorinë adekuate ekonomike me qëllim të prezantimit të drejtë të tyre në PFV.		
2	Realizimi i buxhetit	Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i PK-së duhet të ndërmarrin një vlerësim sistematik të arsyeve për mos-realizimin e projekteve kapitale, dhe për nivelin e ulët të shpenzimit të buxhetit në këtë kategori. Për tejkalimin e barrierave eventuale të identifikuar duhet të përcaktohen masa konkrete dhe praktike në mënyrë që ekzekutimi i projekteve kapitale dhe buxhetit të përmirësohet		
3	Menaxhimi i Personelit	Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i PK duhet të sigurojnë që sistemimi i stafit policorë në pozita të lira të bëhet pas plotësimit të kriterëve apo rekrutimit të rregullt brenda PK dhe kompensimi i të punësuarve të bëhet në përputhje me gradat dhe sistemin aktual të aprovuar të pagave.		

4	Menaxhimi i Personelit	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të AME-së duhet të iniciojë një rishikim gjithpërfshirës për të përcaktuar saktë nevojat për staf, me qëllim që të gjitha pozitat e nevojshme të plotësohen me staf të rregullt. Në rast se shfaqet nevoja për të shërbime të veçanta, ato duhet të sigurohen duke ju nënshtruar kërkesave dhe procedurave ligjore.
5	Menaxhimi i Personelit	Drejtori i Përgjithshëm i AME-së duhet të sigurojë që në rast të nevojës për të angazhuar staf për kohë të shkurtër, do të respektohen të gjitha procedurat ligjore, vlerësimi i kandidatëve nga komisioni rekrutues të jetë korrekt dhe i bazuar, në mënyrë që të angazhohen personat që i plotësojnë të gjitha kriteret e kërkuara për pozitat përkatëse.
6	Mallra dhe shërbime si dhe shërbime komunale	Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së të sigurohet që çdo kontratë të nënshkruhet pasi të jenë zbatuar të gjitha procedurat e kërkuara me LPP dhe rregulloret plotësuese. Në rastin e ofertave me çmime jo-normalisht të ulëta të shqyrtohet besueshmëria e tenderëve dhe të kërkohen sqarimet e nevojshme nga komisioni vlerësues i ofertave para se të procedohet me hapat e mëtutjeshëm.
7	Çështjet e përbashkëta Mallra dhe Shërbime dhe IK	Ministri duhet të siguroj funksionimin efikas të mekanizmave dhe kontrolleve financiare, me qëllim që të respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave.
8	Pasuri	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së duhet të bëjnë një vlerësim të gjendjes aktuale në flotën e automjeteve për të përcaktuar veprimet e nevojshme për përmirësimin e procesit të servisimit të automjeteve.
9	Pasuri	Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i AME-së duhet të sigurojnë që e gjithë pasuria me vlerë nën 1,000€, të regjistrohet në e-pasuria, si dhe të bëhet inventarizimi i pasurisë dhe të harmonizohen raportet e inventarizimit me regjistrat e pasurive para se të përgatiten PFV e vitit 2019.
10	Paraja dhe ekuivalentet e saj	Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave duhet të marrin veprime aktive që avancet e hapura fillimisht të identifikohen dhe më pas të mbyllen.
11	Të arkëtueshmet	Drejtori i përgjithshëm i PK-së duhet të siguroj që regjistrimi i dënimeve mandatore në sistemin elektronik të bëhet në bazë të shumave që janë shqiptuar në dënime, në mënyrë që informatat lidhur me këto llogari të jenë të sakta dhe si të tilla, të raportohen në PFV.
12	Auditimi i Brendshëm	Drejtori i AKSP-së duhet të sigurojë që pozita e mbetur e lirë të plotësohet brenda një afati të arsyeshëm kohor.
13	Menaxhimi i Rrezikut	Ministri duhet të siguroj që personat përgjegjës janë duke i përmbushur të gjitha obligimet në lidhje me menaxhimin e rrezikut, përfshirë këtu edhe vendosjen e mekanizmave adekuat të rishikimit dhe raportimit për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE/PRANORJA/PRIJEMENJE: - 7 05. 2019 DATES/PRIMENJE/ACCEPTED: - 7 05. 2019			
Njësia Org. Org. Unit	Shif. Klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Pr. Prot. Prot. No.	Nr. i faqeve Br. Stranica No. Pages
03	47	687	1



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS- VLADA KOSOVA- GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME / MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSLOVA MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Generalkog Sekretariat Office of the Secretary General	
Nr. Br. No. 307	Nr. i. Br. i. No. og 1
Data/Godina/Date 03 05 2019 PR SHITINË PRISTINA PRISTINA	

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA / VLADA / GOVERNMENT

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME / MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSLOVA/
MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS

ZYRA E SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM/ KANCELARIA STALNOG SEKRETARA
OFFICE OF THE SECRETARY GENERAL

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Zyrës Kombëtare të Auditimit në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Lulzim Ejupi

Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme,

3 maj 2019, Prishtinë.

Faqe 1 nga 1